



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 697 / 8 prot.

Tiranë më 30.7.2020

REKOMANDIM

Nr. 20, datë 30.7.2020

PËR "ALBANIA DEPT COLLECTION AGENCY" SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar (në vijim, "*Ligji*"), ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" (në vijim "*Kodi i Procedurave Administrative*"), procesverbaleve të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Albania Dept Collection Agency SHPK,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.123, datë 13.07.2020 dhe Urdhrit nr. 125, datë 13.07.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë "Albania Dept Collection Agency" SHPK, me objekt:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetasit G.V. dhe R.V, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.
- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetasi A.D., në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Hetimi administrativ, pranë "Albania Dept Collection Agency SHPK", u fokusua në:

- (i) trajtimin e ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit nga subjektet e të dhënave personale G.V., R.V. (bashkëshortja e debitorit/dorëzansit) dhe A.D., ku pretendohet se "Albania Dept Collection Agency SHPK" ka kryer përpunim të të dhënave personale në kundërshtim me parashikimet e Ligjit; dhe
- (ii) verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga "Albania Dept Collection Agency SHPK" gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit, vëren se:

1. “Albania Dept Collection Agency SHPK” ka për objekt të veprimtarisë së saj, ndër të tjera, *“ofrimin e konsulencës ligjore, mbledhje detyrimesh, etj”*.

“Albania Dept Collection Agency SHPK” është autorizuar nga shoqëria “Micro Credit Albania” SHA, në bazë të Kontratës së Shërbimit *“Për shërbimet e konsulencë, përfaqësim, avokati, gjerim, agjenci, negociim, informim”*, datë 15.03.2018 (në vijim, *“Kontrata e Shërbimit”*), për mbledhjen e detyrimeve të debitorëve ekzistues, të cilët rezultojnë të kenë vonesa në pagesat e detyrimeve të tyre kontraktuale ndaj kësaj të fundit.

Referuar marrëdhënies kontraktore të krijuar lidhur me ofrimin e shërbimit të mbledhjes së detyrimeve të pashlyera, që sanksionohet në Kontratën e Shërbimit, “Micro Credit Albania” SHA konsiderohet *“kontrollues”* dhe “Albania Dept Collection Agency SHPK” si *“përpunues”*, pasi i përpunon të dhënat personale të kreditorëve në emër dhe për llogari të kontrolluesit.

Për të dhënat personale që “Albania Dept Collection Agency” SHPK përpunon jashtë parashikimeve të marrëveshjes të delegimit të përpunimit me “Micro Credit Albania” SHA, “Albania Dept Collection Agency” SHPK gëzon statusin e kontrolluesit.

2. Në kuadër të verifikimit të ankesës të paraqitur nga subjektet e të dhënave personale, G.V. dhe R.V., rezultoi se:

“Micro Credit Albania SHA ka vënë në dispozicion të Albania Dept Collection Agency SHPK, sipas Kontratës së Shërbimit, ndër të tjera, të dhënat e dorëzanësit G.V., si dhe i ka dërguar këtij të fundit, në rrugë shkresore, kërkesën për shlyerjen e detyrimit.

Nga analizimi i provave rezultoi se të dhënat në çertifikatën personale e cila ndodhet në dosjen e kredisë të G.V., konkretisht *“emri, atësia, mbiemri dhe datëlindja”*, përputhen me të dhënat e fotokopjes së çertifikatës të paraqitur nga ana e ankuesit. Nga grupi i hetimit administrativ u konstatua se pretendimi i tij, se nuk është personi i njëjtë me atë që është nënshtruar kontrata e kredisë, bazuar në provat e mbledhura, nuk rezulton i vërtetë.

Në kërkesën për shlyerjen e detyrimit evidentohen edhe të dhënat personale të bashkëshortes së ankuesit R.V., të tilla si *“emër, atësi, mbiemër, datëlindje”*, çka provon se janë përpunuar edhe të dhënat personale të saj.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se “Albania Dept Collection Agency SHPK” nuk provon marrjen e pëlqimit për përpunimin e të dhënave të subjektit të të dhënave (R.V.), e cila nuk është palë e kontratës së dorëzansisë të nënshkruar nga dorëzanësi G.V.

3. Në kuadër të verifikimit të ankesës të paraqitur nga A.D. rezultoi se:

“Micro Credit Albania SHA” ka vënë në dispozicion të “Albania Dept Collection Agency” SHPK, sipas marrëdhënies kontraktuale të lidhur ndërmjet tyre, ndër të tjera, të dhënat e dorëzuesit A.D., si dhe i ka dërguar këtij të fundit, në rrugë shkresore, kërkesën për shlyerjen e detyrimit.

Në këtë kërkesë, për shlyerje detyrimi, evidentohen edhe të dhënat personale të bashkëshortes së ankuesit (dorëzuesit) V.D., të tilla si “*emër, atësi, mbiemër, datëlindje*”, çka provon se janë përpunuar edhe të dhënat personale të saj.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se “Albania Dept Collection Agency” SHPK nuk provon marrjen e pëlqimit për përpunimin e të dhënave të subjektit të të dhënave V.D., e cila nuk është palë e kontratës së dorëzuesit të nënshkruar nga dorëzuesi A.D.

Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit. Në këtë rast, ekzistenca e pëlqimit është e vetmja mundësi për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale të ankuesve. Për sa kohë përpunimi i të dhënave nuk është parashikuar në marrëveshjet e kredive të nënshkruara nga ankuesit me “Albania Dept Collection Agency SHPK”, kontaktimi i subjekteve të tjera të të dhënave është i paligjshëm duke cënuar edhe parimin e sanksionuar në germën “a” në pikën 1 të nenit 5 të Ligjit.

Ky lloj përpunimi nuk është në përputhje me detyrimin e parashikuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 6 të Ligjit, në të cilën parashikohet se të dhënat personale përpunohen “*nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin*”.

4. Në germën “d” të nenit 1 të Kontratës së Shërbimit është parashikuar se “Albania Dept Collection Agency SHPK” duhet të kontaktojë vetëm klientin/debitorin e “Micro Credit Albania SHA”, nëpërmjet të dhënave dhe kontakteve të marra prej kësaj të fundit.

Në këtë rast, “Albania Dept Collection Agency SHPK” ka përpunuar të dhënat e R.V. dhe V.D. në kundërshtim me këtë parashikim kontraktual, duke vepruar gjithashtu në kundërshtim me parashikimin në germën “a” të pikës 1 të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 19*”).

5. Në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale gjatë veprimtarisë tregtare, nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se “Albania

nenit 21 të Ligjit.

Nga ana tjetër, nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit, rezultoi se “Albania Dept Collection Agency SHPK” nuk ka kryer përditësimin përkatës për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sa i përket:

- (i) deklarimit në rubrikën 1.1 “*Të dhënat e subjektit kontrollues*”, konkretisht “*adresa*”;
- (ii) deklarimit në rubrikën 1.2 “*Personi i kontaktit i ngarkuar nga subjekti kontrollues*”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e njoftimit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i rezervojnë shprehimisht dispozitat e ligjit.

6. “Albania Dept Collection Agency SHPK” nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin Shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Rezulton mosplotësim i detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018, të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, “Albania Dept Collection Agency SHPK”, është e detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit “*Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 48*”), si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalet përkatëse dhe, në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave, “Albania Dept Collection

Agency SHPK” është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i “Albania Dept Collection Agency SHPK” paraqiti pretendimet me shkrim, si dhe dokumente ilustruese për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si më poshtë

- Lidhur me mosrespektimin e detyrimeve ligjore të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit në drejtim të pretendimeve të ankueseve, R.V. dhe V.D., të cilat nuk janë pjesë e kontratës së kredisë/dorëzarisë, “Albania Dept Collection Agency” SHPK ka informuar se përfshirja e familjarëve kryhet pasi tërheqin të drejta lidhur me pasuri të palës debitore të cilat i nënshtrohen regjimit martesor ose bashkësisë familjare.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky përpunim nuk bazohet në asnjë nga kriteret ligjor për përpunimin e të dhënave personale të parashikuara në pikën 1 të nenit 6 të Ligjit.

- Sa i përket konstatimit se “Albania Dept Collection Agency SHPK” nuk ka respektuar detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr.19, “Albania Dept Collection Agency SHPK” ka informuar se, më datë 23.07.2020, ka ndryshuar kontrata sipas parashikimeve ligjore për delegimin e përpunimit të të dhënave.
- Sa i përket konstatimit në lidhje me njoftimin pranë Zyrës së Komisionerit, për përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, “Albania Dept Collection Agency SHPK” ka paraqitur, më datën 14.07.2020, formularin e njoftimit të përditësuar.
- Lidhur me ekzistencën e SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale, “Albania Dept Collection Agency SHPK” deklaroi se është në proces të krijimit të këtij sistemi në përputhje me Udhëzimet nr. 47 dhe nr. 48.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e “Albania Dept Collection Agency SHPK” me grupin e kontrollit administrativ dhe reagimin e saj për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 20, 21, 29, 30, 31 (pika 1, gërma “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun II të Ligjit si dhe të marrë masa të menjëhershme për fshirjen e të dhënave të përpunuara në kundërshtim me të.

vëmendje përditësimin e “ formularit të njoftimit” në lidhje me përpunimin e të dhënave për të cilat është përgjegjës, në rast ndryshimi të gjendjes së përpunimit;

3. “Albania Dept Collection Agency SHPK”, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e stafit të saj, si dhe sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të krijohet në përputhje me standardin ISO/IEC 270001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, si dhe mund të certifikohet, për qëllime përputhshmërie me standardin në fjalë, nga organizma të akredituar dhe autorizuar në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi. Në këtë rast, Kontrolluesi, në zbatim të germës “b” të pikës 42 të Udhëzimit nr. 47, depoziton pranë Zyrës së Komisionerit një kopje të certifikatës së përputhshmërisë;

4. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32, të Ligjit të përmbushen detyrimet në vazhdimësi dhe rast pas rasti detyrimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, si dhe të përmbushet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve detyrimi i treguar në pikën 3.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data marrjes dijeni të këtij akti;

5. Kontrolluesi “Albania Dept Collection Agency SHPK” të njoftojë Komisionerin për masat e marra.
6. Në rast mospërmbushjeje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 30.7.2020

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

